



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 09. 01. 2026		
Njësi.org. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
15-401/04-00015 97/26		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

RAPORTI I PUNËS

(Janar – Dhjetor, 2025)

Bazuar në planin e punës për vitin 2025, në vijim janë të paraqitura aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit raportues.

- Monitorimi dhe zbatimi i Rregullores për Orarin e Punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës - është përcjellur gjatë tërë vitit zbatimi i kësaj rregulloreje në teren, si dhe është monitoruar dhe përditësuar orari i kujdestarive për barnatore.
- **Zona Industriale** – Pas nënshkrimit të marrëveshjes se bashkëpunimit në mes të komunës dhe MINT në vlerë rreth 4,000,000 €, kanë filluar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, i cili do të bëjë ndërtimin dhe rregullimin e hapësirave të Zonës. Këto procedura janë duke u zhvilluar nga MINT.
- **Ndërtimi i Tregut të Gjelbër** – Qëllimi i këtij projekti është krijimi i hapësirave të përshtatshme për bizneset vendore /fermerët për shitjen e produkteve /prodhimeve bujqësore. Është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me MZHR dhe pas përfundimit të procedurave të prokurimit është lidhur kontrata në vlerë 1,455,954.50 €. Punimet janë duke vazhduar dhe janë në përfundim e sipër. Deri më tani kanë përfunduar rreth 70% e punës së ndërtimit.
- **Projekti “Ngritja dhe Zhvillimi i Bizneseve”** – ka pasur për qëllim mbështetjen me pajisje pune Bizneset Ekzistuese dhe Start-up. Projekti është realizuar me dy thirrje ku prej tyre kanë përfituar 114 përfitues dhe janë shpërndarë 251 pajisje. Përfitues janë 85 nga gjinia femërore/gra dhe 29 nga gjinia mashkullore/burra. 61 përfitues janë nga kategoria Start-up, ndërsa 53 përfitues janë Biznese Ekzistuese. Vlera totale e projektit që është realizuar është 264,240 euro. Vlera totale që kanë përfituar gra është 172,470 euro dhe burra 91,770 euro.

- **Ngritja e infrastrukturës së turizmit** – Si pasojë e gjendjes së rënduar të objekteve të ish – Kooperativave Bujqësore dhe me lejen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është bërë rrënim i këtyre objekteve dhe është krijuar hapësirë e gjelbëruar për pushim dhe rekreacion. Vlera e kontratës ka qenë 99,999.70€ dhe punimet janë zhvilluar në fshatrat: Dumnicë në vlerë 40,537.50€, Kërpimeh në vlerë 54,705.00€, Bajcinë në vlerë 2,920.00€, si dhe në Llapashticë dhe Sfeqël në vlerë 1,837.20€.
- **Projekti “Ditët e Fundvitit”** – Janë dhënë në shfrytëzim gjashtë shtëpiza të drurit: tri (3) për biznese artizanale dhe tri (3) për gastronomi.
- **Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 (SZHEL)** - Është monitoruar në vazhdimësi zbatimi i kësaj strategjie. Është hartuar raporti i mbikëqyrjes së projekteve të përfshira në SZHEL, të cilat kanë qenë të parapara të përfundojnë gjatë vitit 2025. Raporti është përgatitur në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë dhe publikuar në web-faqen e komunës.
- Raportimi në SEMPKE - me Grupin Komunal për Raportim në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Performancës Komunale (SEMPKE) kemi udhëhequr procesin e raportimit për vitin 2024, i cili ka zgjatur nga data 15.02.2025 – 19.06.2025. (vonesat kanë qenë për shkak të problemit me sistemin e SEMPKE-së). Performanca komunale gjatë vitit 2024 ka qenë 64.52%.
- Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 gjithashtu është udhëhequr nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Planifikimit Strategjik në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, GIZ-in gjermanë dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ku janë mbajtur trajnime dhe takime/punëtori. Poashtu, në bashkëpunim edhe me Institutin e Prishtinës për Studime dhe Opinione Publike (PIPOS) është bërë inventarizimi, analizimi dhe njehësimi i shërbimeve në komunën tonë.
- Është rekrutuar një Zyrtarë e koordinimit të investimeve të diasporës, e cila ka filluar punën.
- Janë lëshuar 13 çertifikata të stazhit/përvojës së punës për personat që kanë ushtruar aktivitet ekonomik në sektorin privat gjatë viteve të paraluftës.

- Janë vendosur të dhënat në Programin e Investimeve Publike (PIP) në kuadër të Ministrisë së Financave (periudha 2024-2026).
- Kemi marrë pjesë në trajnime dhe puntori të ndryshme , qëllimi i të cilave ka qenë shkëmbimi i informatave, ngritja e kapaciteteve të punëtorëve, menaxhimi i projekteve. Në AZHR kemi mbajtur 3 puntëori, KIESA- 2 punëtori, GIZ-i- 3 punëtori, Demos- 4 punëtori, RELOAD- 2 punëtori, KLGI- 1 punëtori, GAP- 2 punëtori. Takime kemi pasur edhe me Alenancen e bizneseve shqipëtare dhe Ambasaden e Zvicrres, me qëllim fuqizimin e bizneseve.
- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka realizuar këto punë dhe aktivitete :

Nr.	Aktiviteti	Nr. i lëndëve
1.	Regjistrime të bizneseve të reja	414
2.	Shuarje të bizneseve	39
3.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	178
4.	Certifikata të reja dhe duplikat	51
5.	Informata biznesi	344
6.	Refuzime	6
TOTALI		1032

- Janë ofruar këshilla dhe asistencë për bizneset, të rinjtë dhe qytetarët për fushën dhe kompetencën që ne mbulojmë.
- Janë ekzekutuar 503 pagesa ne vlerë prej 1247,60€ për të cilat i raportohet edhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Janë zgjidhur të gjitha lëndët që janë adresuar në DPZHE në programin Intranet iu është dhënë zgjidhja adekuate sipas veprimit.
- Janë ndjekur puntori që kanë të bejnë me fushën e regjistrimit të bizneseve nga ana e zyrtarëve tanë.
- Janë leshuar 3 vërtetime për shtëpi të djegura.

09.01.2026



Drejtori i DPZHE:
Z. Vigan Salihu